



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Leksikologji e Gjuhës B

Ngarkesa: 4 ETCS, 20 orë leksione, 20 orë seminare

Viti / Semestri : Viti II / Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyruar

Programi i studimit: Bachelor në GjuhëAngleze

Kodi i etikës ; Kodi i etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva te përgjithshme lëndore: Të pajisë studentët me njohuri bazë mbi dukuritë leksikologjike kryesore të gjuhës angleze. Të zhvillojë aftësinë e tyre për përdorimin e saktë dhe funksional të njësive leksikore. Të edukojë studentët për rëndësinë e burimeve ndihmëse si fjalorët dhe tekstet gjuhësore në procesin e të nxënës.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të nxisë analizën e strukturës dhe funksionit të fjalëve në gjuhën angleze (p.sh., sinonimia, antonimia, polisemia, etj.).
2. Të inkurajojë përdorimin praktik të fjalorëve dygjuhësh dhe njëgjuhësh gjatë ushtrimeve gjuhësore.
3. Të motivojë studentët të punojnë në mënyrë të pavarur për pasurimin e leksikut dhe aftësimin për të zgjedhur mjetet e duhura të shprehjes.

Rezultatet e pritshme:

1. Studentët do të jenë në gjendje të identifikojnë dhe analizojnë dukuritë leksikore themelore në gjuhën angleze.
2. Studentët do të demonstrojnë përdorim të drejtë të fjalorit dhe do të zgjerojnë fondin e tyre leksikor në mënyrë të qëndrueshme.
3. Studentët do të zhvillojnë kompetenca për të përdorur mjete ndihmëse (si fjalorët dhe tekstet) në mënyrë të pavarur për të kuptuar dhe përdorur leksikun në kontekst.